

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha balancat janë në lekë)

1. Informacionetëpërgjithshme

“AXO Group” Sh.p.k, është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 26 Nëntor 2018. Kapitali regjistruar është 100.000 leke dhe ortakët i vetëm z. Pier Luigi Massa. Veprimtaria kryesore tregtare e shoqërisë për vitin ushtrimor 2020 janë shërbimet në fushën e Call Centre.

2. Përmbledhje e politikave kontabel

Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elementetë metodave të tjera dhe parimit të drejtave të kostatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar (“lekë”).

Ne paraqitjen e pasqyrave financiare të vitit 2020 është zbatuar formati i SKK-2.

Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqëria, janë si me poshtë:

➤ Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e shërbimeve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përllorogarithen me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tregtarëve dhe në të njëjtin ushtrim kontabel me të ardhurat e lidhura.

➤ Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetare të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetare, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2020 janë sipas kursit të rakorduar me bankat.

➤ Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për të paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Shoqëria për vitin për 2020 rezultoi me fitim në shumën **1,569,478** lekë.

➤ Kërkesat për t’u arkëtuar

Kërkesat për t’u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogaritë të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t’u arkëtuar në para regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuara. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t’u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

➤ **Pasivet financiare**

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

➤ **Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara**

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me koston minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Në se vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve

2. Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare në banke dhe arke, në leke dhe valute, në datat 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2020 janë si më poshtë:

Emertimi llogarise	Monedha	Viti 2020	Viti 2019
Aktivet monetare		633,328	9,126
Banka	leke	87,943	9,126
Arka	leke	545,385	0
Investime			
<i>Në tituj pronësie të njësisve ekonomike brenda grupit</i>			
Aksionet e veta			
Te tjera Financiare	leke	4,403,117	

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike të monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit të ushtrimit të bankes respektive.

3. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Në fund të ushtrimit kontabel 2020 deklarohen si vijon: Kerkesat e arketueshme dhe aktive të tjera financiare, në fillim dhe në fund të periudhës raportuese

		Viti 2020	Viti 2019
	Të drejta të arkëtueshme	3,827,064	7,583,260
1	<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	802,545	7,361,898
2	<i>Nga njësitë ekonomike brenda grupit</i>		
3	<i>Tatim fitimi i mbipaguar</i>	44,869	78,000
4	<i>TVSH e mbipaguar</i>	1,739,650	143,362
5	<i>Ngurtesime</i>	1,240,000	

Në "Llogari / Nga aktiviteti Shfrytëzimit" janë pasqyruar faturat e papaguara për shërbimet e ndërtimit që shoqëria ka realizuar gjatë ushtrimit. Kjo llogari është e rakorduar me llogaritë analitike për çdo klient.

4. Detyrime afatshkurtera-Huamarriet - Huatë dhe Parapagimet

Huate dhe parapagimet afatshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel paraqiten si vijon:

		Viti 2020	Viti 2019
Nr.	Detyrime afatshkurtra:	10,209,259	8,635,690
1	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	1,825,650	3,041,215
2	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	1,815,293	1,815,293
3	Të pagueshme ndaj punonjësve	4,535,399	1,886,718
4	Të pagueshme për detyrimet tatimore:	2,032,917	1,892,464
5	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	1,914,509	1,794,763
6	TAP	46,358	11,644
7	Tatim ne burim	72,050	86,057

“Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit” pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likuaduar ne fund te ushtrimit. Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor.Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

7.Kapitalet e veta

Kapitali i rregjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKB.Me 31.12.2020 ai eshte 100.000 leke, i ndare ne 100 kuota ose aksione.

8.Fitimi (humbja) e vitit financiar

➤ Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve (kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

Nr		Viti 2020	Viti 2019
1	Te ardhura nga aktiviteti shfrytezimit	57,433,775	37,935,814
2			
	Shuma	57,433,775	37,935,814

Te ardhurat nga shitja e sherbimeve ne vleren 57.433.775 lekë jane vleresuar me vleren e drejte te shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme.Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre.

➤ Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Konsumi i materialeve,mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumet e paguara ose te pagueshme.Kostoja e punësimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit jane treguar ne pasqyren perkatese.

9. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel dhe vitin paraardhes jane si vijon:

	Viti 2020	Viti 2019
<i>Rez. Fitimit bruto:</i>	1,569,478	29,405
<i>Humbja nga viti paraardhes</i>	(1,043,830)	(1,172,710)
Fitimi para tatimit	740,873	(1,043,830)
<i>Tatim fitimi</i>	111,131	-
Fitimi neto:	629,742	(1,143,305)
<i>Shpenzime te panjohura</i>	215,225	99,475

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatueshem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme.

10. Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksione dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre, veç huase se marre nga ortaku gjate vitit qe eshte mbyllur nuk ka transaksione te tjera me palet e lidhura.

11. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.

Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare te shoqerise, rezulton se ne vitin ushtrimor qe po paraqesim eshte rritur shifra e afarizmit dhe fitimi tregtar.

ADMINISTRATORI
PIER LUIGI MASSA

